

Vendim nr. 305 datë 17.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 17.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (H) 2024 të Regjistrimit
Themeltar, që i përket:

KËRKUES: HASAN ROQI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 7497, datë 01.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 395, datë 16.02.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1294, datë 03.04.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me objekt “Rivendosje në posedim”, për shkak të bazueshmërisë së tyre në një certifikatë të paligjshme pronësie, nr. 243947, datë 20.03.2010 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të konstatuar absolutisht të pavlefshme me vendimin e formës së prerë nr. 106, datë 07.02.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit. Nisur nga neni 81, pika 2, shkronja “d” të Kushtetutës, dispozitat e Kodit Civil dhe Kodit të Procedurave Administrative, të njohura nga neni 1, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (më tej ligji nr. 8577), shpallin NUL çdo veprim, si dhe vendimet e mësipërme të dala mbi bazën e kësaj certifikate të pavlefshme, që nga

momenti i lëshimit të saj, si gjendje ku ka mungesë të plotë veprimi juridik nga akti. Akti që në momentin e nxjerrjes së tij nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë. Certifikata e pronësisë, si akt absolutisht i pavlefshëm, nuk është akt, por është një nulitet i plotë që nuk ka hyrë kurrë në fuqi, si pasojë e të cilit edhe vendimet gjyqësore të mbështetura mbi të mbeten një NULITET i pastër, të dhëna në shkelje të ligjit e Kushtetutës.

Certifikata absolutisht e pavlefshme e pronësisë dhe vendimet gjyqësore të nxjerra në bazë të saj janë në shkelje me kërkesën e pikës 4 të nenit 81 të ligjit nr. 8577, pasi kanë shkelur më parë vendimin përfundimtar të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 2227, datë 08.10.1997, lënë në fuqi nga Gjykata e Kasacionit, nga Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 76, datë 08.11.2000. Kanë shkelur nenin 28 të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe UKM, nr. 3, datë 21.06.1993 në zbatim të tij të cilat e kishin njohur kërkuesin dhe familjen e tij bashkëpronarë ligjorë në 37% të pronës. Vendim dhe ligj të botuara në fletoren zyrtare, të shkelura arbitrarisht nga gjykatat e ligjit në shkelje të nenit 145, pika 1, të Kushtetutës. Gjykatat e ligjit vlerësuan si ligj e Kushtetutë certifikatën absolutisht të pavlefshme në vendime me anësi ekstreme kundër kërkuesit. Kanë shkelur vendimet unifikuese të KBGJL-së, ligjin e Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese në respekt e mbrojtje të Kushtetutës, vendimit të saj nr. 76/2000 dhe ligjit UKM nr. 3, datë 21.06.1993 të botuara në

fletore zyrtare, të nëpërkëmbura nga gjykatat e ligjit, kërkoj t'i shfuqizoj të gjitha vendimet gjyqësore, të mbështetura në nulitet.

Rivendosja në gjendjen e mëparshme e kërkuetit dhe familjes së tij.

BAZA LIGJORE:

Nenet 5, 7, 11, pika 2, 15, pikat 1 dhe 2, 17, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1, 2 dhe 3, 25, 37, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2, 44, 81, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, 100, 117, pika 1, 118, pikat 1 dhe 2, 122, pika 2, 124, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pikat 1 dhe 2, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 141, pikat 1 dhe 2, 142, pikat 1 dhe 3 dhe 145, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, 8, pika 1, 13, 14 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; nenet 1, pika 2, 26, pikat 1 dhe 2, 27, pikat 1, 2 dhe 3, 36, 37, 39, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 43/b, pikat 1 dhe 2, 48, pikat 1 dhe 2, 49, pikat 3, shkronja “e” dhe 4, 50, pika 4, 71, 71/a, pikat 1 dhe 2 dhe 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe shtetasi S.R., në cilësinë e palës paditëse, kanë paraqitur një kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt rivendosjen në posedim nga të paditurit të banesës nr. 33, të ndodhur në Tiranë, rruga “Mujo Ulqinaku”. Ndërkohë, nga pala e paditur, pasi u bë prezent fakti mbi provat e paraqitura nga pala paditëse, u kërkua rrëzimi i padisë si e pabazuar në prova dhe në ligj.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7497, datë 01.07.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pambështetur në ligj. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse (kërkuesi).

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 395, datë 16.02.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 7497, datë 01.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse (kërkuesi).

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1294, datë 03.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

5. Në datën 15.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.10.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, duke argumentuar se:

6.1. Ai dhe familja e tij janë posedues të ligjshëm të banesës objekt gjykimi në gjykatat e zakonshme, pasi fillimisht me aktin administrativ autorizimin e kontratën përkatëse, nga njësia e qeverisjes vendore, lagje 14 dhe Ndërmarrjes Komunale Banesa nr. 3, Tiranë, kanë qenë qiraxhi shteti. Më vonë i është njohur investimi në pjesën 37% në banesë, shtesa e truall, sipas veprimit juridik, vendimit gjyqësor përfundimtar nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 76/2000. Pagesa e kundërshtëpërblimit nga të paditurit është bërë pas 11 vjetësh e gjysmë. Kërkuesit dhe familjes së tij i është garantuar prona si bashkëpronar në vlerën 37%, fituar me vendim gjyqësor dhe me ligj, në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, ai është posedues i ligjshëm i pronës.

- 6.2. Sipas nenit 308 të KC-së paditësit prezumohen të kenë qenë posedues të ligjshëm që nga data 08.10.1998. Ndërsa, sipas nenit 311 të KC-së mbrojtja e posedimit të paditësve nënkupton mbrojtjen e vendimeve gjyqësore të cilat u caktuan pjesën 37% të investimit në pronë paditësve. Sipas nenit 315 të KC-së, gjatë gjykimit të padisë për rivendosjen në posedim, i padituri nuk mund të pretendojë se është vetë pronar ose ka një të drejtë më të fortë se ajo e poseduesit, aq më tepër me titull bashkëpronar ligjor. Vendimet gjyqësore në kërkesëpaditë me objekt “lirim dhe dorëzim banese” dhe “rivendosje në posedim” kanë cenuar të drejtën e pronës që rrjedh nga posedimi, të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës.
- 6.3. Gjykata me vendimin e saj nr. 76/2000 ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe mbas këtij vendimi nuk ka dalë asnjë vendim tjetër që ta kundërshtojë atë. Në këtë kuptim, ai është i detyrueshëm dhe ka forcën e ligjit. Të drejtat e njohura nga ai vendim i Gjykatës janë cenuar nga vendimet gjyqësore për kërkesëpaditë me objekt “lirim dhe dorëzim banese” dhe “rivendosje në posedim”. Gjykatat kanë marrë kompetencat e Gjykatës, duke shfuqizuar vendimin e saj nr. 76/2000 dhe ligjin për llogari të palës së paditur, në shkelje të neneve 7 dhe 145, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, duke shkelur të drejtat që ai vendim i Gjykatës i kishte njohur kërkuarit.
- 6.4. Gjykatat nuk kanë respektuar vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nuk kanë verifikuar origjinën e pronës së paditësve. Paditësit janë posedues të ligjshëm të banesës dhe oborrit, pasi në pikën 9, shkronja “ç”, të udhëzimit nr. 3, datë 21.06.1993 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr. 7698, datë 15.04.1994 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, për shkak të mospagesës së detyrimit të kundërvleftës monetare, nga të paditurit, brenda afatit 1-vjeçar, nga momenti që vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë mori formë të prerë, kur paditësit janë njohur bashkëpronarë ligjor në masën 37%. Kërkuari ka paraqitur padinë e rivendosjes në posedim brenda afatit ligjor 6-mujor nga cenimi i posedimit. Padia është ngritur në datën 20.06.2012, ndërsa paditësi është nxjerrë nga banesa në datën 12.01.2012. Pra, padia është ngritur 22 ditë përpara përfundimit të afatit 6-mujor të cenimit të posedimit.
- 6.5. Trashëgimtarja e paditësit S.R. nuk është njoftuar nga Gjykata e Lartë për datën dhe orën e gjykimit në atë gjykatë, duke i mohuar të drejtën për të paraqitur pretendimet e saj në atë gjykim.

6.6. Neni 467 i KPC-së nuk është i vlefshëm vetëm për gjykatat e faktit, por edhe për Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji. Sipas nenit 472, pika 1, shkronja “ç”, të KPC-së, ky fakt përbën shkelje të rëndë të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose procedurën e gjykimit, sipas nenit 467 të KPC-së, duke e bërë të pavlefshëm vendimin e Gjykatës së Lartë. Gjykata e apelit, me vendimin nr. 28, datë 02.03.2010, nuk ka urdhëruar pagesën e detyrimit monetar prej 286.890 lekësh jashtë afatit prekluziv 1-vjeçar. Afati i marrëdhënies së detyrimit është shuar në datën 08.10.1998.

6.7. Të paditurit në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në shkelje e mashtrim të ligjit, konkretisht neneve 106 dhe 107 të KC-së, kanë paguar kundërvleftën mbas 11 vjetësh e gjysmë, në një kohë që sipas ekspertizës së ekspertës, investimi i kërkuarit në vitin 2010 ishte 4.604.199 lekë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka vlerësuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individët janë subjekte të kushtëzuara dhe mund të paraqesin ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre të drejtpërdrejta, duke provuar se janë cenuar në të drejtat e tyre kushtetuese, pra se janë viktimat e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për to (*shih vendimet nr. 6, datë 15.02.2024; nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se individët duhet të

provojnë legjitimimin e tyre si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 65, datë 30.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa më lart, në lidhje me pretendimin e kërkuarit se Gjykata e Lartë nuk ka njoftuar trashëgimtaren e paditësit S.R. për datën dhe orën e gjykimit në atë gjykatë, Kolegji evidenton se ai nuk provon interesin e tij të drejtpërdrejtë në drejtim të së drejtës së cenuar dhe interesit të ligjshëm vetjak, për sa kohë që përmes këtij pretendimi ai synon mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, që nuk janë pjesë e këtij gjykimi kushtetues. Për këtë arsye, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae* për këtë pretendim.

10. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Po ashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kriteri i shterimit të mjeteve që shqyrton ajo lidhet edhe me pretendimet e paraqitura nga individë në ankimin kushtetues individual. Sipas Gjykatës, individë të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë duhet t’i ketë paraqitur më parë edhe në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjithashtu, Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 40, datë 25.06.2015; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa më lart, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, referuar edhe rekursit të paraqitur nga kërkuesi në Gjykatën e Lartë, Kolegji konstaton se argumentet mbi të cilat ai ka ngritur pretendimet e tij për cenimin e procesit të rregullt ligjor, të paraqitura nëpërmjet ankimit kushtetues individual, nuk janë ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mosshtruar kështu mjetet juridike efektive për to. Po ashtu, referuar pretendimeve të kërkuesit, bazuar në natyrën e tyre dhe përmbajtjen e argumenteve, mbi të cilat janë mbështetur ato, Kolegji vëren se, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për pretendimet e tij, pasi, *së pari*, ai nuk ka shtruar mjetet juridike efektive për to dhe, *së dyti*, pretendimet e tij, për nga natyra e tyre, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

14. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.